



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 711 / 18 prot.

Tiranë, më 16 . 5 .2024

V E N D I M

Nr.17, datë 16.5.2024

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 25, DATË 23.10.2017, "PËR NORMIMIN DHE SHPËRBLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE, NË ZBATIM TË PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR DHE VAZHDUES, NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS"

Mbështetur në nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 243 dhe 248 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë"; në nenin 124 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; si dhe të ligjit nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023"; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 11.6.2009, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", (i ndryshuar), me propozim të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues, i mbledhur më datë 16.5.2024,

V E N D O S I:

1. Në lidhjen nr.1 "Konvertimi i elementeve për përgatitjen dhe mbështetjen e procesit të formimit profesional në kuadrin e Formimit Fillestar dhe Vazhdues, në pikën I "Anëtarët e komisioneve të pranimit në Shkollën e Magjistraturës", shtohet pika 8, si vijon:

8.	Vlerësimi i ankesave të fazës së parë të provimit të pranimit, nga anëtarët e jashtëm të komisionit të vlerësimit elektronik.	0.3 orë mësimore /kandidat
----	---	----------------------------

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.